**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**
**Nr. 25 datë 20.12.2019**

# PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.1, DATË 22.01.2016 " PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR " TË NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, pika 1.3, shkronja "a", nenit 35, nenit 54 shkronja "f", nenit 55 pika 3, të ligjit nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore " të ndryshuar; ligjin nr.44/2015 " Kodi i procedurave administrative ne Republiken e Shqiperisë "; ligjin nr.68/2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore "; ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore " të ndryshuar; ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " të ndryshuar; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin ", të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimeve, në VKB nr.1, datë 22.01.2016 " Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër ", të ndryshuar, sipas lidhjes bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

**Sekretar i Këshillit**
**Denis Lesha**

**KRYETARE**
**Brisela KADIJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SHKODËR

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al,*

# PAKETA FISKALE
# BASHKIA E SHKODRËS
# (e përditësuar)

**"Për një qeverisje vendore që synon të rrisë kapacitetet fiskale dhe administrative për realizimin e funksioneve në përgjegjësinë e saj, përmes taksimit të drejtë, gjithpërfshirëse e me përgjegjësi sociale"**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

Rr. 13 Dhetori nr.1
4001 Shkodër - AL
+35522400150
info@bashkiashkoder.gov.al
bashkiashkoder.gov.al

**Përmbajtja**


A.1 Mbi Bashkinë Shkodër 5
A.2 Procesi i Hartimit të Paketës fiskale 6
A.3 Çfarë prezanton paketa fiskale? 10
A.4 Kuadri ligjor dhe nënligjor 11
B. Paketa Fiskale 14
Kapitulli I: Taksat vendore 14
I.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël 14
I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme 15
I.3.Taksa e fjetjes në hotel 20
I.4.Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja 22
I.5.Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit: 25
I.6. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme 26
I.7. Taksa e tabelës 27
Kapitulli II: Taksat e ndara 31
II.1Taksa e mjeteve të përdorura të transportit. 31
II.2Taksa e rentës minerare. 31
II.3 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale 32
Kapitulli III: Tarifat vendore 32
III.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave 32
III.2 Tarifa e ndriçimit 36
III.3 Tarifa e gjelbrimit 39
III.4 Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër 41
Kapitulli IV. Gjoba, Kamatvonesa 61
IV. 1. Kamatvonesë për mosshlyerje në afat të detyrimit 61
IV.2. Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore 62
IV.3. Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundërvajtjet administrative 62
Kapitulli V Të ardhura jo tatimore 67
V.1. Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë 67
V.2. Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime 67
V.3. Të ardhura nga shitja e mallrave dhee shërbimeve 67
V.4.Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara 67
V.5. Të ardhura nga privatizimi 67
V.6. Të ardhura nga komisioni si agjent tatimor. 68
V.7. Të tjera. 68


REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

Lista e tabelave:

TABELË 1. NDARJA NË LAGJE DHE FSHATRA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË SHKODRËS ............... 5
TABELË 2. NIVELET E TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL............................................ 14
TABELË 3. NIVELI I TAKSËS MBI TOKËN BUJQËSORE ........................................................................ 18
TABELË 4. NIVELI I TAKSËS MBI TRUALLIN ........................................................................ 19
TABELË 5. TAKSA E FJETJES NË HOTEL ........................................................................ 21
TABELË 6. NIVELI I TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË ........................................................................ 22
TABELË 7. LLOJET E NDËRTIMEVE DHE INVESTIMEVE TË NDRYSHME NGA ATO TË PËRCAKTUARA MË SIPËR .... 23
TABELË 8. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME ........................ 26
TABELË 9. TAKSA E TABELËS ........................................................................ 29
TABELË 10.TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TE MBETURINAVE PËR FAMILJET........................................................ 33
TABELË 11 TARIFË PASTRIMI PËR INSTITUCIONE........................................................................ 33
TABELË 12. TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE PËR BIZNESET........................................ 33
TABELË 13. TARIFË NDRIÇIMI PËR FAMILJE ........................................................................ 37
TABELË 14. TARIFË NDRIÇIMI PËR INSTITUCIONE........................................................................ 37
TABELË 15. TARIFË NDRIÇIMI PËR BIZNESIN........................................................................ 37
TABELË 16. TARIFË GJELBRIMI PËR FAMILJE........................................................................ 39
TABELË 17. TARIFË GJELBRIMI PËR INSTITUCIONET ........................................................................ 39
TABELË 18. TARIFË GJELBRIMI PËR BIZNESIN ........................................................................ 40
TABELË 19. PËRJASHTIMET PËR INDIVIDËT DHE FAMILJET NGA TARIFA E PASTRIMIT, TARIFA E NDRIÇIMIT DHE TARIFA E GJELBRIMIT. ........................................................................ 41
TABELË 20. TARIFA PËR APLIKIM DHE ÇERTIFIKATË PËRDORIMI ........................................................................ 41
TABELË 21. TARIFA PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE ........................................................................ 42
TABELË 22. TARIFA PËR SHËRBIM VETERINER ........................................................................ 43
TABELË 23 TARIFAT E LIÇENSIMIT TË VEPRIMTARIVE TË TRANSPORTIT ........................................................ 43
TABELË 24. TARIFA PËR PARKIMIN ........................................................................ 45
TABELË 25. DHËNIE LIÇENSA PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ ........................ 47
TABELË 26. PËR TARIFAT NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË KULLOTAVE TARIFAT BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË ........................................................................ 47
TABELË 27. TARIFË BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË, PËR LLOJET INDUSTRIALE ........................................ 48
TABELË 28. TARIFAT DYSHEME PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE ........................................................................ 48
TABELË 29. TARIFAT PËR NGRITJEN E KAMPINGJEVE, QENDRAVE DHE OBJEKTEVE TË LËVIZSHME .................. 51
TABELË 30.TARIFAT PËR GRUMBULLIMIN DHE NXJERRJEN E PRODHIMEVE TË DYTA ........................................ 51
TABELË 31.TARIFAT E SHITJES SË PEMËVE TË KRISHTLINDJEVE DHE TË VITIT TË RI ........................................ 52
TABELË 32. TARIFAT E SHITJES SË FIDANËVE NGA RIPËRTËRITJA NATYRORE, E SHPATULLAVE DHE E KALEMAVE ........................................................................ 52
TABELË 33. TARIFA PËR SHËRBIMET BUJQËSORE DHE PYJORE ........................................................................ 52
TABELË 34.TARIFA SHËRBIMI NGA INSTITUCIONET E KULTURËS, SPORTIT........................................................ 53
TABELË 35.TARIFA SHËRBIMI NGA INSTITUCIONET E KOPSHTEVE DHE ÇERDHEVE ........................................ 55
TABELË 36.TARIFA PËR SHËRBIMET ADMINISTRATIVE ........................................................................ 56
TABELË 37 TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYEN STRUKTURA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI ............ 57
TABELË 38. NIVELI I TARIFËS PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE ........................................................ 59
TABELË 39. NIVELI I TARIFËS PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE INERTE NË LANDFILLE ........................................ 60
TABELË 40. MOSSHLYERJE TË DETYRIMEVE TATIMORE (TAKSA, TARIFA) ........................................................ 61
TABELË 41. GJOBA NGA KONTROLLET DHE INSPEKTIMET TATIMORE........................................................ 62
TABELË 42. NIVELI I GJOBAVE PËR DËMTIM DHE NDËRHYRJE NË INFRASTRUKTURËN RRUGORE........................ 62
TABELË 43. NIVELI I GJOBAVE PËR NDOTJE TË HAPËSIRËS PUBLIKE ........................................................ 62
TABELË 44. NIVELI I GJOBAVE PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TREGËTAR PA LIÇENSË, AUTORIZIM APO LEJE PËRKATËSE ........................................................................ 63
TABELË 45.NIVELI I GJOBAVE PËR DËMTIMET DHE NDËRHYRJET NË RRJETIN E NDRIÇIMIT RRUGOR ................ 64
TABELË 46. NIVELI I GJOBAVE PËR DËMTIME DHE NDËRHYRJE NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT ........................ 65
TABELË 47. NIVELI I GJOBAVE PËR NDËRHYRJE DHE DËMTIME NË HAPËSIRAT E GJELBËRTA ........................ 65

TABELË 48. NIVELI I GJOBAVE PËR INSPEKTORIATIN VETERINAR ........ 65
TABELË 49. NIVELI I GJOBËS PËR PËRDORIMIN E PA AUTORIZUAR TË LOGOS SË BASHKISË SË SHKODRËSDHE MOSRESPEKTIM I AKTEVE, VENDIMEVE ADMINISTRATIVE TË DALA NGA KËSHILLI BASHKIAK DHE KRYETARI I BASHKISË ........ 65

## A.1 Mbi Bashkinë Shkodër

Konteksti i Bashkisë Shkodër paraqet jo vetëm zgjerim gjeografik të kufijve administrativë, por edhe shumëllojshmëri të territorit. Bashkia mbulon tashmë territore, që shtrihen nga Alpet e përfundojnë në bregdet, duke përfshirë ekosisteme e tipologji të ndryshme terrenesh. Secili nga këto territore ka ndërthurjen e vet të traditave, burimeve natyrore, burimeve ekonomike e cilësive infrastrukturore. Bazuar në politikat zhvillimore të territorit të Bashkisë së Shkodrës, veprimet tona duhet t'i japin vlerë zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe traditave tona kulturore. Ndaj çështja kryesore është gjetja e mundësive që të kthejmë këtë shumëllojshmëri në avantazh konkurues dhe çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e Bashkisë.

Për të krijuar këtë mjedis, ne do të fokusojmë punën në përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, fizike dhe financiare.

Sipas Ligjit nr 115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", *Njësi Administrative Shkodër* quhet zona urbane që zinte Bashkia Shkodër përpara ndarjes së re territoriale.

Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës nr.1, të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

Tabelë 1. Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë së Shkodrës

| nr | Njësi Administrative | Lagje / Fshatra |
|---|---|---|
| 1 | Shkodër | 5 Lagje |
| 2 | Ana e Malit | 10 fshatra |
| 3 | Bërdicë | 6 fshatra |
| 4 | Dajç | 11 fshatra |
| 5 | Guri i Zi | 11 fshatra |
| 6 | Postribë | 11 fshatra |
| 7 | Pult | 7 fshatra |
| 8 | Rrethinat | 10 fshtra |
| 9 | Shalë | 11 fshatra |
| 10 | Shosh | 5 fshatra |
| 11 | Velipojë | 10 fshtra |

## A.2 Procesi i Hartimit të Paketës fiskale

Pas bashkimit të menjëhershëm të 11 (njëmbëdhjetë) njësive të qeverisjes vendore, Bashkia e Shkodrës u ballafaqua me nevojën e hartimit të një pakete fiskale të integruar dhe të aplikueshme në të gjithë territorin.

Nga analiza e dokumentave vendorë (paketat fiskale të Bashkisë qendër dhe të ish komunave) kemi trashëguar probleme që lidhen me:

- Aplikimin e niveleve të ndryshme të pa studiuara, të taksave dhe tarifave vendore, në njësi të ndryshme;
- Referencë dhe aplikim jo i duhur i bazës ligjore;
- Paqartësi në aplikimin e procedurave nga ana e administratës;
- Mungesë analize dhe plani menaxhimi për shërbimet publike (mbledhja-grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, ndriçimi rrugor, gjelbërim, mirëmbajtje infrastrukturë rrugore, mirëmbajtje rrugë rurale, ofrimi dhe menaxhimi i shërbimit me ujë të pijshëm, mirëmbajtje objekte të arsimit parashkollor, mirëmbajtje të objekteve të arsimit, mirëmbajtje të objekteve në shërbimin shëndetësor, etj.);
- Mungesë e analizës së kostove sipas standarteve për shërbimet publike;
- Mungesë e bazës së të dhënave të plota për bizneset;
- Mungesë e bazës së të dhënave të plota për familjet dhe individët;
- Mungesë e bazës së të dhënave për ndërtesat;
- Mungesë e bazës së të dhënave për tokën bujqësore;
- Mungesë e një plani për zënien e hapësirës publike;

Pas rreth katër vite pune, Bashkia Shkodër, tashmë, ka ndërtuar një sistem të Integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksapaguesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit.

Pas katër vitesh Bashkia Shkodër është bashkia që vetë ka bërë të mundur:

- Studimin dhe aplikimin e niveleve të ndryshme të studiuara të taksave dhe tarifave vendore, në njësi të ndryshme, sipas tipologjisë dhe sipas ndarjes territoriale.
- Referencë dhe aplikim i duhur i bazës ligjore: Auditimet e kryera nga niveli qendror, ministria e Financave klasifikon Bashkinë Shkodër ndër bashkitë që ka dhënë shembullin dhe eksperiencën pozitive për t'u bashkëndarë me bashkitë e tjera.
- Ka bërë analizën dhe planinemenaxhimi për shërbimet publikesi:
    - Plani për menaxhimine mbetjeve të ngurta urbane,
    - Studim dhe analizë të kostove,të përditësuar vit pas viti, për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve,
    - Studim dhe analizë, të përditësuar vit pas viti, të kostove për shërbimin e ndriçimit rrugor në qytet dhe njësi administrative,
    - Analizë të kostos për shërbimin e gjelbërimit,

- Planifikim dhe përmirësim të analizave të kostove për mirëmbajtjen në infrastrukturën rrugore dhe rrugë rurale,
- Përmirësimnë diferencimin e taksimit, si dhe tarifimit sipas llojit të shërbimit, standartit, vendodhjes, etj.
- Lehtësi për grupe të veçanta, përjashtime apo incentiva të nevojshme.
- Përmirësim të shërbimit dhe përmirësim të dukshëm të treguesve të performancës të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Analizë të përmirësuar dhe planifikim për shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve të arsimit parashkollor, 9 – vjeçar dhe arsimit të mesëm.
- Planifikim dhe analizë për përmirësimin e mirëmbajtjes së objekteve në shërbimin shëndetësor, etj.);
- Analizë të përmirësuar të kostove sipas standarteve për shërbimet publike: menaxhimi i mbetjeve, shërbimi i kullimit, gjelbërimi, ndriçimi rrugor, etj.
- Bazë e të dhënave të plota për bizneset;
- Bazë e të dhënave tëpërditësuar dhe përmirësuar për familjet dhe individët;
- Standartizim të procedurave administrative të aplikueshme nga administrata vendore në te gjithë territorin.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe përditësimit te regjistrave të saktë elektronikë, të nevojshëm për llogaritjen e kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye i është kushtuar vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, janë ushtruar verifikime te vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitallzimin e tyre, me efekt arritjen e rezultateve shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesorë të të ardhurave.

Vëmendje dhe punë të vazhdueshme i kemi kushtuar përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësimit dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Kështu janë vënë ne funksion module të reja për dixhitalizimin on-line të akt-kontrolleve të mbajtura në terren, është mundësuar hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të inspektoriatit dhe Policisë Bashkiake, është mundësuar llogaritja automatike e kamatvonesave përmes sistemit elektronik, është mundësuar llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë Zyës së Integruar me Një Ndalesë (ZI1N) për subjektet shfytëzuese të hapsirave publike, parkingjeve, ambulantëve etj.
Bashkia Shkodër ka krijuar aplikacionin "Taksat e Mia Shkodër", për smartphone, ku mundësohet llogaritja e taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore sipas adresave, vitit fiskal, dhe kategorisë familjare.

Është mundësuar lidhja on-line me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, dhe ka filluar përditësimi i të dhënave për subjektet dhe familjet.

Megjithë punën e bërë ka nevojë të vazhdohet puna për përmirësimin e të dhënave në sistemin e adminstrimit elektronik. Këto të dhëna lidhen kryesisht me:

- Plotësimin e bazës së të dhënave për ndërtesat;
- Plotësimin e bazës së të dhënave për tokën bujqësore;
- Plotësimin e bazës së të dhënave për hapësirën publike (territore të zëna me ndërtesa informale, objekte të tjera pronë publike, rrugë,sheshe, trotuare, çdo pronë tjetër publike)
- Hartimin e një plani për parkimin publik;Për të arritur këto synime është e domosdoshme dhe vendimmarrëse bashkëpunimi dhe dhënia e informacionit të detyrueshëm nga Agjensia

Shtetërore e Kadastrës (ish ZVRPP, Ish ALUIZNI). Megjithë vështirësitë, Bashkia Shkodër do të përpiqet të verifikojë hap pas hapi në territor përmes inspektimit dhe akteve të verifikimit, duke saktësuar kështu përditë të dhënat fiskale.

Grupi i punës:

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Shkodër:

- Drejtoria e të Ardhurave,
- Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor,
- Drejtoria e Financës,
- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Investimeve dhe Infrastrukturës,
- Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit,
- Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve,
- Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Terrritorit,
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit,
- Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave,
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse,
- Drejtoria Juridike,
- Z. Kryetarët,
- Kabineti,
- Administratorët e njësive administrative,



**Konsultimi me qytetarë dhe grupe interesi**

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë së Shkodrës janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet sipas kalendarit më poshtë:

| Nr. | Data | Njësia Administrative | Ora | Vendi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | E shtune<br>7 shtator 2019 | Rrethina, Pult, Shosh, Shalë | 16:00 | Njësia Administrative Rrethina |
| 2 | E enjte<br>19 shtator 2019 | Velipojë | 10:00 | Njësia Administrative Velipojë, Salla e Mbledhjeve |
| 3 | E marte<br>17 shtator 2019 | Ana e Malit | 15:00 | Njësia Administrative Ana e Malit, Salla e Mbledhjeve |
| 4 | E enjte<br>12 shtator 2019 | Bërdicë | 15:00 | Njësia Administrative Bërdicë |
| 5 | E premte ,<br>13 shtator 2019 | Dajç | 14:00 | Njësia Administrative Dajç, Salla e Mbledhjeve |
| 6 | E merkure ,<br>11 shtator 2019 | Postribë | 09:00 | Njësia Administrative Postrribë, Salla e Mbledhjeve |
| 7 | E merkure ,<br>11 shtator 2019 | Guri i Zi | 13:00 | Qendra Komunitare në Gurin e Zi |
| 8 | E enjte<br>12 shtator 2019 | Lagje nr. 3<br>Lagje nr. 4<br>Lagje nr. 5 | 10:00 | Salla e Këshillit të Bashkisë Shkodër |
| 9 | E premte<br>13 shtator 2019 | Lagje nr. 1<br>Lagje nr. 2 | 10:00 | Salla e Këshillit të Bashkisë Shkodër |
| 10 | E premte<br>13 shtator 2019 | Organizatat e Shoqerisë Civile në fushën e shërbimeve sociale | 11:00 | Biblioteka "Marin Barleti"Shkodër |

Për ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë takime konsultative gjithpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janëbërë propozime për përmirësim.

Përmbledhje të takimeve, sugjerimet dhe çdo informacion tjetër është afishuar për transparencë dhe konsultim në faqen web të Bashkisë Shkdoër:

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_per_keshillim_me_publikun_Per_draftin_e_projektplanit_buxhetor_afatmesem_2020_2022_dhe_ndryshimeve_ne_paketen_fiskale_te_Bashkise_1476_1.php

Mbas diskutimeve dhe konsultimeve me publikun të realizuara nëpërmjet diskutimeve publike që Bashkia Shkodër ka organizuar në Lagjet e Qytetit dhe në Njësitë Administrative, pas vlerësimeve të propozimeve dhe sugjerimeve të ardhura në formë shkresore pranë zyrës me një ndalesë, apo përmes sekretarisë së këshillit bashkiak, pasi janë marrë në konsideratë këto sugjerime dhe janë vlerësuar referuar bazës ligjore të aplikueshme, është hartuar paketa fiskale me ndryshimet e reflektuara në Projekt – vendimin për miratim "Për disa ndryshime në VKB nr. 1, dt. 22.01.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA SHKODËR

## A.3 Çfarë prezanton paketa fiskale?

Vizioni ynë, për një territor bashkiak të integruar, parashikon planifikim dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm të balancuar për të gjithë territorin, duke mbrojtur burimet natyrore. Kjo qasje bazohet në përforcimin e identitetit të secilës zonë të Bashkisë, duke patur parasysh burimet natyrore, profilin ekonomik dhe produktet, shtrirjen e shërbimeve dhe traditën, me synimin e përhershëm të rritjes së nivelit të jetesës.

Miradministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të të ardhurave si dhe zbatimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhëresave, zbatimi i ligjit përbën moton e punës tonë.

Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara.

Ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuara në planet tona strategjike më afatgjata.

Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, mbetet pikë kyçe e suksesit jo vetëm në hartimin e politikës fiskale, por sidomos për zbatimin e saj.

Nga analiza e ecurisë së realizimit të të ardhurave të deritanishme rezulton se ka burime akoma të pashfrytëzuara në kapacitetet optimale. Kjo vërehet pothuaj në të gjitha njësitë administrative.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, ju paraqesim paketën fiskale me ndryshimet e propozuara. Propozimet janë në përputhje me ndryshimet ligjore të ndodhura. Ato konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, duke patur parasysh që paketa fiskale është e integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

a) Përditësimin dhe aplikimin e kornizës ligjore të ndryshuar;
b) Përditësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për vjeljen e çdo takse dhe tarife, pjesë e kësaj pakete fiskale.
c) Përmirësimin e sistemit fiskal efiçent dhe transparent;
d) Përcaktimine qartë në seksione të taksave dhe tarifave.
e) Është synuar në një
   - ✓ Taksim të drejtë;
   - ✓ Tarifim tëmbështetur në kosto shërbimi;
   - ✓ Klasifikim i biznesit sipas qarkullimit vjetor, llojit të aktivitetit, vendodhjes, etj.

h) Aplikimi i incentivave, lehtësirave fiskale, përjashtimeve për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, për aq sa lejon dhe lejon ligji.

## A.4 Kuadri ligjor dhe nënligjor

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetqeverisjen vendore"*, Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- ✓ Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël;
- ✓ Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
- ✓ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- ✓ Taksa e fjetjes në hotel;
- ✓ Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- ✓ Taksa e tabelës/reklamat;
- ✓ Taksa e mjeteve të përdorura të transportit;
- ✓ Taksa e rentës minerare;
- ✓ Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale;
- ✓ Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

**Ligje:**

- ✓ Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015;ndryshuar me Ligjin nr.106/2017; ndryshuar me Ligjin Nr. 41/2018;Aktin Normativ Nr. 3, datë 2.10.2019;
- ✓ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetqeverisjen vendore"' i ndryshuar*
- ✓ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, *"Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 *"Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar;*
- ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, *"Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar";
- ✓ Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, *"Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";*
- ✓ Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 *"Për taksat kombëtare"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 93/2015 *"Për turizmin", i* ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"*, i ndryshuar;

- ✓ Ligji Nr 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.10465, datë 29.9.2011 *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
- ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 *"Për fondin kullosor"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 *"Për kundravajtjet administrative"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;*
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
- ✓ Ligji. nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- ✓ Ligji nr. 22/2018 "Për strehiminsocial";

**Vendime dhe udhëzime:**

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 *"Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit"*;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, *"Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore"*;
- ✓ VKM Nr.7, datë 4.01.2012, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare"*, i ndryshuar.
- ✓ VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 *"Për përcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"* ;
- ✓ VKM Nr. 396, datë 21.6.2006 *"Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore";*
- ✓ VKM nr. 391 datë 21.06.2006 *"Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave";*
- ✓ VKM 632 datë 11.06.2009 *"Për tarifat në sektorin e Kullotave"*,
- ✓ VKM nr.1064 datë 22.12.2010 *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave"*;
- ✓ VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;*
- ✓ VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 992, datë 9.12.2015 *"Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, të ndryshuar;
- ✓ VKM Nr.469, datë 3.6.2015, *"Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore"*;
- ✓ VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- ✓ VKM Nr. 285, date 27.6.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj";
- ✓ VKM Nr.1108, date 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave te Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit";

- ✓ VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", neni 27 pika 4;
- ✓ VKM nr. 132, datë 7.3.2018 për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës.
- ✓ Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 4.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 *"Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor"*;
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave*Nr.32, datë 31.12.2013, "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël"*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, *"Për taksat kombëtare"*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 *"Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Proceduriale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore "*;
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 *"Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, *"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar;*
- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çeshtjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 *"Udhëzues për zbatimin e VKM nr.l108 dat.30.l2.20l5 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme"*;
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr 189, datë 04.05.2018 *"Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedh, të imta, derra të therura në thertore"*
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr 190, datë 04.05.2018 *"Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinare që shoqëron lëvizjen dhe transportin e ngarkesave me lëkurë dhe produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor".*

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA SHKODER

# B. Paketa Fiskale

## Kapitulli I: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

### I.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) Lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Baza e taksës/tatimi: Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë Lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Niveli i tatimit: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si më poshtë:

Tabelë 2. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

| I.1 | Shkalla Tatimore | Njësia | Niveli ligjor i Tatimit | |
|---|---|---|---|---|
| | | | NjA Shkodër | NjA të tjera |
| A | Me qarkullim vjetor nga 0 - 5.000.000 Lekë | Lekë/vit | 0 | 0 |
| B | Me qarkullim vjetor nga 5.000.001 – 8.000.000 Lekë | Lekë/vit | 5 % e fitimit | 5 % e fitimit |

**Mënyra e pagesës:** Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit:** Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit

pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

## I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

"Pasuri e paluajtshme" janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
"Kadastra Fiskale" është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

### I.2.1 Taksa mbi ndërtesat

1. **Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë**, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

**Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat**[1]

[1] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:
*a)"Të shtohet si grup i përjashtuar nga taksa e banesës familjet me femijë me aftësi ndryshe dhe familjet me kryefamiljare gra". b) Të shtohet si grup i përjashtuar nga taksa e banesës bizneset që hapen në vitin 2020 nga persona nën 30 vjeç nëse vendi ku zhvillojnë aktivitetin është në pronësi të tyre ose me kontratë qiraje konform ligjit. c) Diferencimi i nivelit të taksës së ndërtesës...."*
Kategoritë që përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën përcaktohen në ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, në nenin 22 "Taksa mbi ndërtesat". Ky përcaktim ligjor është i detyrueshëm për Bashkinë.

a. ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
b. ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
c. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
d. ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.
e. ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
f. banesat sociale në pronësi të bashkive;
g. pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkinë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
h. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
i. pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
j. strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";

**Baza e taksës**

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

**Shkalla e taksës**

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:
a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**Që nga data 01.01.2019 aplikohet nënndarje zonale ku perfshihen të gjitha njësitë administrative (përveç zonës së qytetit dhe zonave të plazhit Velipoje dhe Baks/Rrjoll), për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës minus 30 (tridhjetë) për qind për çdo lloj ndërtese.**

Ndërkohë që, që nga data 01.01.2019 aplikohet nënndarje zonale ku perfshihen të gjitha njësitë administrative (përveç zonës së qytetit dhe zonave të plazhit Velipoje dhe Baks/Rrjoll), për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës minus 30 (tridhjetë) për qind për çdo lloj ndërtese. Bashkia Shkodër e ka bërë diferencimin në taksën e ndërtesës dhe në çdo taksë dhe tarifë tjetër sipas shtrirjes gjeografike ku theksojmë se subjektet që ushtrojnë aktivitet në Njësi Administrtaive kanë taksa dhe tarifa të reduktuara sipas Paketës Fiskale.

**Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim**[2]

a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.

b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit.

c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit.

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.

d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

e) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

Detyrimi për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë ose vetëm për taksat dhe tarifat vendore, pranëUjësjellës Kanalizime sh.a. Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton përkatësisht 2% (dy përqind) të shumës së arkëtuar[3].

---

[2] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:

- a)"Biznese prodhimi (veçanërisht ato të prodhimit për eksport dhe artizanatit) të kënë ose nivel më të ulët se tregtia dhe/ose një periudhë një vjeçare "grace" për të gjithë ato që fillojnë aktivitetin rishtazi."

- b)"Bizneset e shërbimit soft: profesionistë të lirë, agjenci, dhe shërbime profesionale, qofshin edhe mjekësore e veterinare të taksohen me një normë të diferencuar nga tregtia dhe prodhimi, mundësisht një normë që të mos kalojë 1 herë çmimin e taksës për metër katror të godinës së banimit"

Referuar ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar me Ligjin Nr. 106/2017, ligjin 95/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632,datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 7.3.2018 "Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".

Është e pamundur që të përcaktojmë/verifikojmë nëse subjektet realizojnë apo jo eksport te prodhimeve të tyre.

[3] -c)*"Të ulet në 1% (ngjashëm me Drejtorinë e tatimeve) komisioni i agjenturës së ujesjellësit për vjeljen e taksës mbi ndërtesën, tokën bujqësore, truallit."*

Bashkia Shkodër ka caktuar si Agjent të sajin tatimor UKSh. Përqindja e komisionit te shërbimit që UKSH mban si Agjent Tatimor është përllogaritur si një vlerë e reduktuar në 2% në krahasim me normën 4 % të përcaktuar sipas projekt vendimit nr. 40 datë 31.07.2019 të Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë dërguar për mendim të gjitha Bashkive, ku në nenin 3

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin faturohen direkt nga Drejtoria e te Ardhurave në bashkinë Shkodër, me bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, ne sportelete Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal.

### I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

**Përkufizimi:*"Tokë bujqësore"*** është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

**Baza e taksës**: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të marrjes së tokës nëpronësi, çertifikatës së regjistrimit të tokës.Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

**Niveli i taksës mbi tokën bujqësore** caktohet në Lekë për hektar.Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Tabelë 3. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

| Kategoritë mesatare të tokës bujqësore | Njësia | Niveli i taksës mbi tokën bujqësore | |
|---|---|---|---|
| | | Sipas ligjit | Miratuar |
| I | Lekë/ha/vit | 4,200 | 2,940 |
| II | Lekë/ha/vit | 3,500 | 2,450 |
| III | Lekë/ha/vit | 2,800 | 1,960 |
| IV | Lekë/ha/vit | 2,300 | 1,610 |
| V | Lekë/ha/vit | 1,900 | 1,330 |
| VI | Lekë/ha/vit | 1,600 | 1,120 |
| VII – X | Lekë/ha/vit | 1,400 | 980 |

**Detyrimi për pagesë:** Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e të Ardhuravedhe për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë pranëUjësjellës Kanalizime sh.a. Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton përkatësisht 2% (dy përqind) të shumës së arkëtuar. Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin faturohen direkt nga Drejtoria e te Ardhurave në bashkinë Shkodër, me bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, ne sportelet e Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal.

përcaktohet norma 4 % si komision për vjeljen e taksës së pronës. Kjo vlerë është edhe më e vogël se norma prej 3 % që Ish ZVRPP, Agjensia e Kadastrës Shtetërore mban si agjent tatimor për taksën e kalimit të pronësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SHKODËR

**Përjashtime:**Përjashtohen nga taksa, tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës** :Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Shkodër.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP, për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme, duke ia përcjellë këtë informacion me shkrim Drejtorisë së të ardhurave për llogaritjen e detyrimit.

### I.2.3 Taksa mbi truallin

**Baza e taksës**: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabelë 4. Niveli i taksës mbi truallin

| Taksa mbi truallin | Njësia | Niveli i taksës mbi truallin |
|---|---|---|
| | | Sipas ligjit |
| Për qëllime banimi nga individët | Lekë/m$^2$/vit | 0,42 |
| Për qëllime biznesi | Lekë/m$^2$/vit | 18 |

**Detyrimi për pagesë:** Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :**

Detyrimi për familjarët shlyhet si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Ujësjellës Kanalizime sh.a. Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton përkatësisht 2% (dy përqind) të shumës së arkëtuar.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin, faturohen direkt nga Drejtoria e te Ardhurave në Bashkinë Shkodër, me bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, ne sportelet e Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal.

**Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave**

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

## I.3. Taksa e fjetjes në hotel[4]

**Përkufizimi:** Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)"Bujtinë"; b)"Fjetinë" (Hostel); c)"Kamping"; ç)"Hotel"; d)"Motel"; dh)"Resort"; e)"Qendër kurative"; ë)"Fjetje dhe mëngjes" (B&B).

[4] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:
-"*Të krijohet një metode taksimi afrofe (duke prezumuar 50% normë zënie të hotelit, siç është edhe metodologjia e plan biznesit për biznese të ngjashme) për taksën e fjetjes në hotel në mangësi të strukturave kontrolluese- të llogaritet taksa sipas ndarjeve gjeografike duke favorizuar zonat turistike tashmë të konsoliduara dhe rritur normën deri në kufirin ligjor maksimal për hotelet me 5 yje dhe hotelet në qytet dhe ulur në nivelin minimal për zonat malore turistike.*"

Bashkia Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave bën tarifimin e Taksës së fjetjes në hotel, duke u bazuar në kontrolle mujore mbi bazën e deklarimeve të subjekteve akomoduese:
Referuar ligjit, Taksa e fjetjes në hotel përcaktohet mbi bazën e vetdeklarimit të subjekteve, verifikimeve të herëpashërshme mbi bazën e sondazheve nga inspektorët në terren dhe nga verifikimi i kasës fiskale të subjekteve. Baza e vlerësimit të detyrimit është vetdeklarimi, i cili formalizohet me akt kontrollin mujor që përpilohet në subjekt.Për të monitoruar bazën e taksueshme në mënyrë të vazhdueshme ushtrohen kontrolle të ndërmjetme për verifikim numri shtretërish të zënë (persona të akomoduar). Gjithashtu në fund të muajit bëhet verifikimi i xhiros së paisjes fiskale të muajit përkatës.Taksa mujore e fjetjes në hotel vendoset duke marrë në referencë nivelin maksimal ndërmjet ketyre verifikimeve të ndërmjetme, dhe nisur nga kjo nuk është e nevojshme të bëhet një tarifim aforfe.

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: "Bujtinë"Standard, "Fjetinë"Standard, Komfort; "Kamping"Standard, "Hotel" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Motel"Standard, Komfort, Superior; "Resort" tre yje, katër yje, pesë yje; "Qendër kurative" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Fjetje dhe mëngjes" (B&B)Standard, Komfort, Superior.

**Baza e taksës**:Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës se fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Tabelë 5. Taksa e fjetjes në hotel

| Taksa e fjetjes në hotel | Njësia | Niveli i taksës së fjetjes në hotel |
|---|---|---|
| Hotel me 4-5 yje | Lekë/natë qëndrimi/për person | 175 |
| Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin | Lekë/natë qëndrimi/për person | 70 |

**Detyrimi dhe këstet e pagimit:** Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:** Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

## I.4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja[5]

Baza e taksës:Baza e taksës është vlera në Lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në Lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

Tabelë 6. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë

| Nr | Llojet e ndërtimeve dhe investimeve | Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Sipas ligjit | Propozohet në % | Propozohet në % |
| | | Në % të çmimit të shitjes për m² | NjA Shkodër, Velipojë, Rrethina | NjA të tjera |

---

[5] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:

-*"Rritja deri në kufirin maksimal ligjor (pra 8%) të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja në zonën historike të qytetit, rritja në 5% të ndërtesave të reja në zonat e dendura të banimit në qytet, dhe diferencimi mes qytetit dhe fshatit duke lënë zonat rurale me 4%. Një nisëm e tillë do garantonte shperndarje më të mirë të zonave të banimit dhe uljen e stimulit për ndertim në zonat qendrore për të shmangur betonizimin e mëtejshëm të qytetit."*

Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndahet sipas destinacionit te zhvillimit (ndertimit) dhe sipas zonave ne territori e Bashkise Shkoder si me poshte:

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë per zhvillime nga kompanite e ndertimit (ndertime per efekt fitimprures, biznesi)

-Taksimi 4% ne te gjithe territorin e Bashkise Shkoder

-Referenca monetare, cmimi i shitje per m2, 58'000 lek

2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë per zhvillime (ndertime) te ndryshme nga ato te mesipermet ku nder te tjera edhe ato per perdorim vetjak (pra banesat).

-Taksimi 3% ne Qytetin Shkoder, NjA Rrethina dhe Nja Velipoje

-Taksimi 2% ne NjA te tjera.

-Referenca monetare, kostoja e ndertimit per m2, 32'650 lek

- Per diskutimin e rritjes ne nivelin max te Taksës së ndikimit në infrastrukturë ne zonen historike duhet pasur parasysh se planifikimi ne zone parashikohet i limituar per efekt te statusit te zones, percaktuar me VKM 1183 date 05.08 2008 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur në qyetetin e Shkodrës", ku ka percaktimet perkatese te zhvillimit qe relativisht jane "frenuese" (minimaliste per zhvillim prone per "biznes". Zhvillimet ne zonen historike konkretisht, ne pergjithesi kane qene zhvillime familjare.
- Persa i perket rritjes në Taksën e ndikimit në infrastrukturë në 5% ne zonat "e dendura" te banimit perseri duhet pasur parasyshe ngarkesa aktuale e fiskale e disafishuar referuar periudhes para hyrjes ne fuqi te ligjit 107/2014, duhet pasur parasysh pagesa totale e Taksa e ndikimit në infrastrukturë perpara marrjes se lejes, duhet soaruar se per objektet mbi 3 kat eshte dhe tarifa e planifikimit 1% kosto ndertimi dhe se gjithashtu është shtuar edhe kalimi i 3% e siperfaqes se ndertimit ne favor te forndit social te Bashkise.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërtime të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, gjithashtu ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese, si dhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit | 4 – 8 | 4 | 4 |
| 2 | Ndërtesa, më shumë se një ndërtim pa leje, në proçes legalizimi (ndërtesa të dyta). | 4 - 8 | 4 | 4 |

**Baza e taksës**: Baza e taksës është vlera në Lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

Tabelë 7. Llojet e ndërtimeve dhe investimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër

| Nr. | Llojet e ndërtimeve dhe investimeve(ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër) | Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Sipas ligjit | Propozohet në % | |
| | | Në % të vlerës së investimit | NjA Shkodër, Velipojë, Rrethina | NjA të tjera |
| 1 | Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike. | 1 – 3 | 3 | 2 |
| 2 | Ndërtesa, më shumë se një ndërtim pa leje, në proçes legalizimi (ndërtesa të dyta) | 1 - 3 | 3 | 2 |
| 3 | Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte. | 0.1 por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është | 0.1 por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë | 0.1 por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | përfshirë në preventivin e investimit; | në preventivin e investimit; | përfshirë në preventivin e investimit; |
| 4 | Ndërtimet e reja të cilat janë në proçes legalizimi | 0.5 | 0.5 | 0.5 |

**Baza e taksës:**niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

**Detyrimi i pagesës:** Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Përllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:** Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Shkodër.

**Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale**

1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit[6].

**Kushte lehtësuese:** Në rast të zbatimit të një projekti të veçantë për efiçencën e energjisë urbane[7], projekti verifikohet dhe nëse është zbatuar me përpikmëri, atëherë subjektit i rimbursohet taksa e paguar mbi nivelin minimal të përcaktuar me ligj.

**Përjashtime:**
Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

[6]Sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 22/2018 "Për strehimin social"
[7]Sipas përcaktimeve nëLigjin Nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";

Përjashtohen[8] nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:** Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, e cila përcjell informacionin tek Drejtoria e të Ardhurave.

Të gjithë investitorët (individë, persona fizik, OJF, subjektet ndërtuese, etj) do të pajisen me lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Shkodër, vetëm pasi:

- të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe detyrimet përkatëse për tarifën e pastrimit për kantierin e ndërtimit;
- për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, përveç shlyerjes së detyrimeve të mësipërme, duhet edhe të kenë nënshkruar kontratën me Bashkinë Shkodër për fondin e banesave sociale.

Të gjithë individët, persona fizik, OJF, subjektet ndërtuese, etj, do të pajisen me deklaratën paraprake të punimeve pranë Bashkisë Shkodër, vetëm pasi të kenë paguar tarifën e pastrimit për kantierin e ndërtimit.

## I.5. Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

Garancia financiare:Në mbështetje të pikës 10 te VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte",subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, më konkretisht Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit tëTerritorit, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

[8] Me Aktin Normativ Nr. 3, datë 2.10.2019 është shtuar përjashtimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë:
Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, tëVKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimit:** Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Shkodër.

## I.6. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

**Baza e taksës** mbi kalimin e së drejtës së pronësisë *për ndërtesat* është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë *për pasuritë e tjera të paluajtshme* është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

**Niveli i taksës:**Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Tabelë 8. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

| Kategoritë e ndërtesave | Njësia | Bashkia Shkodër |
|---|---|---|
| Ndërtesa banimi | Lekë/m2 | 300 |
| Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime | Lekë/m2 | 700 |
| Ndërtesa të tjera | Lekë/m2 | 500 |

**Detyrimi për pagesën:** Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

**Mënyra e mbledhjes:** Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe*diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Shkodër, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.*

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:** Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish-ZRPP).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

## I.7. Taksa e tabelës

**Baza e taksës:** Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të taksës, tabelat kategorizohen në:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi[9], e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

---

[9] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:
- *"Diferencimi qytet fshat i taksës së tabelës për tabela vetjake apo për tabela me qëllime reklamuese për të tretë."*
Bashkia Shkodër ka lidhur kontrata me subjektet që merren me aktivitet reklamues dhe i ka pajisur me lejet përkatëse per vendosje reklamash brenda territorit të Bashkisë Shkodër. Tabelat reklamuese në të gjithë territorin, në akset nacionale dhe rurale janë pjesë e shërbimit që këto kompani japin. Ato kanë të njëjtin funksion dhe impakt në mjedisin e qytetit dhe njësive administrative si dhe ofrojnë të njëjtin standart shërbimi.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

Tabelë 9. Taksa e tabelës

| Nr. | | Llojet e tabelave | Njësia | |
|---|---|---|---|---|
| I | Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit) | | | |
| a | | deri në 2 m² | Lekë/m²/vit | 0 |
| b | | mbi 2 m² deri 10 m² | | |
| | 1 | e thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/m²/vit | 10,000 |
| | 2 | me ndriçim të thjeshtë | Lekë/m²/vit | 15,000 |
| | 3 | elektronike | Lekë/m²/vit | 20,000 |
| c | | mbi 10 m² deri 20 m² | | |
| | 1 | e thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/m²/vit | 8,500 |
| | 2 | me ndriçim të thjeshtë | Lekë/m²/vit | 12,750 |
| | 3 | elektronike | Lekë/m²/vit | 17,000 |
| ç | | mbi 20 m² deri 40 m² | | |
| | 1 | e thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/m²/vit | 5,500 |
| | 2 | me ndriçim të thjeshtë | Lekë/m²/vit | 8,250 |
| | 3 | elektronike | Lekë/m²/vit | 11,000 |
| d | | mbi 40 m² | | |
| | 1 | e thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/m²/vit | 4,000 |
| | 2 | me ndriçim të thjeshtë | Lekë/m²/vit | 6,000 |
| | 3 | elektronike | Lekë/m²/vit | 8,000 |
| II | Tabela pë qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim | | | |
| a | | Tabela identifikuese | Lekë/m²/vit | 120 |
| III | Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35m² | | | |
| a | | e thjeshtë (me/pa ndriçim) | Lekë/m²/vit | 22,500 |
| b | | elektronike | Lekë/m²/vit | 45,000 |
| IV | | Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. | | |
| a | | Të të gjitha llojeve dhe përmasave | Lekë/m²/ditë | 1,000 |

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do t'i shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., një tabelë të thjeshtë 15 m², shuma e taksës vjetore do të llogaritet (10 m² x 15,000 Lekë) + (5 m² x 12,750 Lekë) = 150,000 + 63,750 = 213,750 Lekë në vit (ose 17,812 Lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritjeje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m². Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelatidentifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m², do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore, në tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllim reklamimi për vete ose të tretë.

**Detyrimi dhe këstet e pagesës:** Detyrimi për Taksën e Tabelës për Kategorinë 1, 2 dhe 3 është vjetor.

- Për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershortë vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 30qershor, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga deklarimi.
- Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKR dhe paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKR.
- Për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30qershor të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër.
- Për "kategorinë 4" detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër dhe paguhet menjëherë.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Shkodër.

**Për Kategorinë Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike:** Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës nga ana e subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton në mënyrë periodike Drejtorinë e të Ardhurave në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shtesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

## Kapitulli II: Taksat e ndara

"Taksë ose tatim i ndarë" është një taksë kombëtare ose tatim i përcaktuar sipas ligjit për procedurat tatimore ose ligjeve të veçanta tatimore, të ardhurat respektive prej të cilave ndahen, plotësisht ose pjesërisht, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre.

Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

### II.1Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.

Baza e taksës: Lloji i mjetit të transportit rrugorështë bazë për taksën:Cilindrata në cm3 x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, 25 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë, i kalojnë si të ardhura buxhetit të qeverisjes vendore.

### II.2Taksa e rentës minerare.

Baza e taksës:Çdo person fizik apo juridik, që është i liçencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë Bashkisë Shkodër, ku zhvillohet veprimtaria.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

## II.3 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

## Kapitulli III: Tarifat vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim qëkëto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/osejuridikë.

Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësiae vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa vetëm për shërbimet publike,konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit apo përfituesit,duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe kostone përballueshme nga të gjithë.

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

### III.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Përkufizimi: "Tarifë e pastrimit dhe largimit të mbeturinave " është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Shkodër dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

Tabelë 10.Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave për familjet[10]

| Nr | Kategoritë | Niveli i Tarifës |
|---|---|---|
| | | Familje Lekë/vit |
| I | **FAMILJARET (për familje)** | |
| I.1 | ***Njësia Administrative Shkodër*** | 3,450 |
| I.2 | *Njësitë e tjera Administrative* | |
| | Postribë | 1,950 |
| | Pult | 1,450 |
| | Shosh | 1,450 |
| | Shalë | 1,450 |
| | Guri i Zi | 1,950 |
| | Bërdicë | 1,950 |
| | Dajç | 1,950 |
| | Velipojë | 1,950 |
| | Ana e Malit | 1,950 |
| | Rrethina | 1,950 |

Tabelë 11 Tarifë pastrimi për institucione

| II | Tarifë pastrimi për institucione | Njësia | Tarifa |
|---|---|---|---|
| | Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj. | Lekë/vit/njësi | 8,000 |

Tabelë 12. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset[11]

[10] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:
-"Diferencimi i tarifës së pastrimit për familjet në bazë të popullsisë së njësisë administrative."
Bashkia Shkodër e ka bërë një gjë të tillë prej disa vitesh, pasi familjet ne Njësitë administrative paguajnë tarifë të reduktuar duke u krahasuar me ato në Qytet. Tarifa teknikisht është përllogaritur bazuar në koston e shërbimit për secilën njësi administrative.

[11] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:
-*"Diferencimi sipas llojit të biznesit të tarifës së pastrimit duke u përshkallëzuar nga më e larta tek më e ulëta: prodhim, tregti (në zona qendrore-në zona periferike), sherbime me tregti (në bazë të vendosjes në hartë dhe hapësirës së zënë me mallra), profesione të lira dhe sherbime agjenture e konsulence, shoqata jo fitimprurëse."*

Gjithashtu, në të gjitha dëgjesat publike, të realizuara nga administrata e Bashkisë Shkodër sipas kalendarit, ankesa më e madhe vjen për ato subjekte me aktivitet supermarket, qendra tregtare, si dhe lokalet e dasmave të regjistruara në QKB si Bar/Restorant/Rostiçeri, etj., të cilët depozitojnë në pikat e grumbullimit mbetje të konsiderueshme, e shpesh herë në mënyrë të pa rregullt, duke ndotur ambientin përreth, duke vështirësuar kalimin e këmbësoreve dhe njëkohësisht duke rënduar edhe shërbimin e pastrimit. Për të bërë të mundur përmirësimin e shërbimit të dedikuar duke vënë në dispozicion konteinerët specifik për këto lloj biznesesh, si dhe duke kryer me cikle të dakordësuara shërbimin e transportit dhe evadimit të mbetjeve, propozohet një shtesë në tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për disa subjekte, duke përdorur si shkallëzim sipërfaqen e objektit ku ushtrohet aktivitetit, e cila për këto subjekte është përcaktuese për sasinë e mbetjeve të prodhuara. Përshkallëzimi i subjekteve për përcaktimin e tarifës së pastrimit është bazuar në sipërfaqen në shërbim të aktivitetit.

| III | BIZNESI | Njësia | Biznes i vogël | Biznes i madh |
|---|---|---|---|---|
| III.1 | **Njësi tregtare dhe shërbimi në Njësinë Administrative Shkodër dhe Velipojë Plazh** | Lekë/vit/njësi | 13,000 | 33,000 |
| III.1.1 | Njësi tregtare, me sipërfaqe ndërtese nga 501-1000 m$^2$ | Lekë/vit/njësi | | 50,000 |
| III.1.2 | Njësi tregtare, me sipërfaqe ndërtese mbi 1000 m$^2$ | Lekë/vit/njësi | | 63,000 |
| III.1.3 | Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese nga 301-500 m$^2$ | Lekë/vit/njësi | 16,000 | 43,000 |
| III.1.4 | Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese mbi 500 m$^2$ | Lekë/vit/njësi | 20,000 | 50,000 |
| III.1.5 | Njësi tregtare dhe shërbimi me kontratë për trajtimin e mbetjeve spitalore. | Lekë/vit/njësi | 6,000 | 25,000 |
| III.1.6 | Njësi shërbimi (këpucar, biçiklist, berber) | Lekë/vit/njësi | 8,000 | |
| III.2 | **Njësi tregtare dhe shërbimi në *Njësitë Administrative* Postribë, Pult, Shosh, Shalë, Guri i Zi, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Ana e Malit, Rrethina** | Lekë/vit/njësi | 8,000 | 33,000 |
| III.2.1 | Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese nga 301-500 m$^2$ | Lekë/vit/njësi | 10,000 | 43,000 |
| III.2.2 | Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese mbi 500 m$^2$ | Lekë/vit/njësi | 12,000 | 43,000 |
| III.2.3 | Njësi tregtare dhe shërbimi me kontratë për trajtimin e mbetjeve spitalore. | Lekë/vit/njësi | 6,000 | 25,000 |
| III.3 | **Njësi tregtare për tregtim karburanti** | Lekë/vit/njësi | | 48,000 |
| III.4 | **Njësi prodhimi** | | | |
| III.4.1 | Njësi prodhimi në Njësinë Administrative Shkodër | Lekë/vit/njësi | 13,000 | 63,000 |
| III.4.2 | Njësi prodhimi në *Njësitë e tjera Administrative* | Lekë/vit/njësi | 8,000 | 33,000 |
| III.5 | **SUBJEKTE NDËRTIMI** | | | |
| III.5.1 | Subjekte ndërtuese për selinë administrative Bashkia Shkodër dhe kantier ndërtimi, adresë sekondare për subjekte me seli jashtë territorit të Bashkisë Shkodër | Lekë/vit/njësi | | 73,000 |
| III.6. | **Investitor/Individ/Persona fizik/ojf/Subjekte ndërtimi sipas investimit/deklaratës paraprake të punimeve dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit për vlera investimi/preventivi:** | | | |
| | • *deri në 5, 000, 000 Lekë* | Lekë/kantier/vit | | 20,000 |
| | • *nga 5,000,001-15,000,000 Lekë* | Lekë/kantier/vit | | 40,000 |
| | • *nga15,000,001-25,000,000 Lekë* | Lekë/kantier/vit | | 60,000 |
| | • *nga25,000,001–50,000,000 Lekë* | Lekë/kantier/vit | | 80,000 |

Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, që lidhen me trajtimin e mbetjeve spitalore, ligjin nr.9357, datë 18.05.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme", dhe rregulloreve në zbatim të tij, shumë subjekte, njësi tregtare dhe shërbimi, që prodhojnë mbetje spitalore, kanë kërkuar një zbritje në tarifën e pastrimit, meqenëse për këto lloj mbetjesh, ato kanë kontratë të lidhur me subjekte te licencuara.Kërkesa e tyre do të merret parasysh me paraqitjen e kontratës së lidhur me subjektet e licencuara për evadim mbetje te rrezikshme spitalore.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | • *nga50,000,001–100,000, 000 Lekë* | Lekë/kantier/vit | | 100,000 |
| | • *nga100,000,001–200,000,000 Lekë* | Lekë/kantier/vit | | 150,000 |
| | • *mbi 200, 000, 000 Lekë* | | | 200,000 |
| III.7 | Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritar | | | |
| III.7.1 | Institucione Administrative Publike | Lekë/vit/njësi | | 8,000 |
| III.7.2 | Organizata të tjera jofitimprurëse | Lekë/vit/njësi | | 6,000 |
| III.8 | **PROFESIONE TE LIRA** | | | |
| | Profesone të lira (avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë). | Lekë/vit/njësi | 8,000 | |
| III.9 | **AMBULANT** | | | |
| 5 | Fotografim i artefakteve muzeale dhe veprave të artit për botime, kartolina, etj. me përjashtim te rasteve kur kërkuesi ka të drejtën e autorit | Lekë/njësi | 1.000 |
| 6 | Dhënie në përdorim salle (për biseda shkencore,takime etj) | Lekë/rast | 3.000 |
| 7 | Tarifë përdorimi i ambjenteve të jashtme nga të tretë për aktivitete | Lekë/orë | 2.500 |
| 8 | Shitje e të drejtës televizive për aktivitete artistike/kulturore të organizuara nga bashkia dhe institucionet e varësise. | Lekë/rast | 25.000 |

| III.4.7.3 | Teatri "Migjeni" | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Shitje e të drejtës televizive për aktivitete të organizuara nga Bashkia dhe institucionet e varësisë | Lekë/shfaqja | 25.000 |
| 2 | Bileta për aktivitete variete | Lekë/bileta | 400 |
| 3 | Bileta për shfaqje të dramës | Lekë/bileta | 300 |
| 4 | Biletat për aktivitete rinore (konkurse, koncerte etj.) për student (i pajisur me kartë studenti)[18] | Lekë/bileta | 0 |
| 5 | Biletat për aktivitete kombëtare | Lekë/bileta | 500 |
| 6 | Biletat për aktivitete ndërkombëtare | Lekë/bileta | 1.000 |
| 7 | Biletat për student (i pajisur me kartë studenti)[19] | Lekë/bileta | 0 |
| 8 | Dhënie e sallës dhe skenës në përdorim për aktivitete artistike | Lekë/orë | 50.000 |
| 9 | Dhënie e sallës në përdorim për mbledhje, takime etj | Lekë/orë | 25.000 |
| 10 | Dhënie holli në katin e dytë në përdorim për mbledhje/takime | Lekë/orë | 15.000 |

[17] Me propozimin e Qendrës Rinore Atelie, organizatës "Kongresi Rinor Kombëtar" propozohet biletë me çmim zero lekë për vizitat në muze për studentët e pajisur me kartë studenti.
18 Me propozimin e Qendrës Rinore Atelie, organizatës "Kongresi Rinor Kombëtar" propozohet biletë me çmim zero lekë, për aktivitetet rinore (konkurse, koncerte etj.) në Teatrin "Migjeni", për studentët e pajisur me kartë studenti.
[19] Me propozimin e Qendrës Rinore Atelie, organizatës "Kongresi Rinor Kombëtar" propozohet biletë me çmim zero lekë për aktivitetet në Teatrin "Migjeni", për studentët e pajisur me kartë studenti.

| III.4.7.4 | Qendra Kulturore e fëmijëve | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Bileta për aktivitete | Lekë/bileta | 100 |
| 2 | Dhënie në përdorim e sallës së koncerteve | Lekë/rast | 15.000 |
| 3 | Shitje e të drejtës televizive për aktivitete artistike/kulturore të organizuara nga bashkia dhe institucionet e varësise. | Lekë/shfaqja | 25.000 |
| 4 | Bileta për Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për fëmijë, nata e pare dhe e dytë | Lekë/bileta | 300 |
| 4.1 | Bileta për Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për fëmijë, nata finale | Lekë/bileta | 500 |
| 4.2 | Biletat për student (i pajisur me kartë studenti)[20] | Lekë/bileta | 0 |

| III.4.7.5 | Pallati sportit " Qazim Dervishi"[21] | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Çmimi biletës për aktivitete sportive kombëtare | Lekë/bileta | 100 |
| 2 | Çmimi biletës për aktivitete sportive ndërkombëtare | Lekë/bileta | 200 |
| 3 | Çmimi i biletës për aktivitete sportive ndërkombëtare (student i pajisur me kartë studenti)[22] | Lekë/bileta | 100 |
| 4 | Dhënie në përdorim e pallatit të sportit | Lekë/orë | 10.000 |
| 5 | Shitje e të drejtës televizive për aktivitete artistike/kulturore të organizuara nga bashkia dhe institucionet e varësise. | Lekë/ndeshje | 25.000 |

| III.4.7.6 | Stadiumi "Loro Boriçi"[23] | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Venie ne dispozicion te Stadiumit "Loro Boriçi", ambienteve te tij dhe sherbimeve qe ofrohen per zhvillimin e ndeshjeve pa ndriçim artificial | Lekë/ndeshje | 300.000 |
| 2 | Venie ne dispozicion te Stadiumit "Loro Boriçi", ambienteve te tij dhe sherbimeve qe ofrohen per zhvillimin e ndeshjeve me ndriçim artificial | Lekë/ ndeshje | 500.000 |

| II.4.7.7 | Qendrat Komunitare | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Dhënie në përdorim sallë e madhe për takime, aktivitete shkencore, sociale, kulturore, | Lekë/aktivitet/dite | 5000 |

[20] Me propozimin e Qendrës Rinore Atelie, organizatës "Kongresi Rinor Kombëtar" propozohet biletë me çmim zero lekë për aktivitetet në Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci", për studentët e pajisur me kartë studenti.

[21] Aktualisht Bashkia Shkodër aplikon çmimin prej 300 Lekë për biletë hyrëse në Pallatin e sportit "Qazim Dervishi", për ndjekjen e ndeshjeve ndërkombëtare.
Duke konstatuar që çmimi ka ndikuar në numrin e ulët të biletave, propozohet që kjo tarifë të ulet, me efekt rritjen e numrit të kërkesave, dhe ruajtjen konstante të të ardhurave totale.Çmimi i propozuar i biletës për aktivitete sportive ndërkombëtare 200 Lekë/bileta

[22] Me propozimin e Qendrës Rinore Atelie, organizatës "Kongresi Rinor Kombëtar" propozohet biletë me 50% zbritje për aktivitetet sportive ndërkombëtare në pallatin e sportit "Qazim Dervishi", për studentët e pajisur me kartë studenti.

[23] Ambjentet dhe fusha në stadiumin "Loro Boriçi", bazuar në kërkesat dhe përcaktimin nga ana e Federatës Shqiptare të Futbollit, mund të ofrohet dhe vihet dispozicion të klubeve që nuk kanë ambiente për zhvillimin e ndeshjeve zyrtare. Tarifat e propozuara më poshtë parashikohet të mbulojnë kostot e mirëmbajtjes së fushës, ambientet e shërbimit dhe dhomave të veshjes, kostot për ujë, energji etj. Tarifat e propozuara i janë referuar ligjit nr 79/2017 "Për Sportin", neni 33 "Shfrytëzimi i objekteve sportive", gjithashtu edhe tarifave të miratuara nga FSHF-ja për vënien në dispozicion të stadiumeve, si dhe tarifave të stadiumeve të tjera me tipologji të njëjtë me stadiumin "Loro Boriçi".

seminare.

| III.4.7.8 | Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Tarifë regjistrimit për pjesmarrje "Çmimi Pjetër Gaci" | Lekë/person | 1.000 |
| 2 | Bileta për aktivitetet kulturore të organizuara nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" | Lekë/biletë | 200 |

| III.4.7.9 | Përdorimi i Markës "ZAHOTEX" nga artizanet e zonës (Zadrima Homemade Textile) e çertifikuar nga Zyra e Patentave dhe Markave Tiranë me Nr Regjistrimi 14058 datë 16.04.2012 është pronësi e pushtetit vendor, i cila gjithashtu ka autoritetin e përdorimit. | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Tarifë Regjistrimi në Markë | Lekë | 5000 |
| 2 | Tarifë etikete "ZAHOTEX" | Lekë/copë | 10 |

Strukturat e ngarkuar për vjeljen e tarifave janë Bibloteka, Muzeumet, Teatri, Drejtoria Ekonomike e Arsimit, Pallati i Sportit, Qendrat komunitare, Qendra "Pjetër Gaci", nga Marka Zahotex, Bashkia Shkodër, institucione që ofrojnë shërbimet.

### *III.4.8. Tarifa shërbimi të tjera.*

Tabelë 35.Tarifa shërbimi nga institucionet e kopshteve dhe çerdheve

| III.4.8.1 | Emertimi | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Tarifë për ushqimin në kopshte | Kuota ditore Lekë/fëmijë | 140 |
| 2 | Tarifë për ushqimin në çerdhet | Kuota ditore Lekë/fëmijë | 110 |

**Përjashtime:**[24]

[24]Në kuadër të politikave sociale që zbaton Bashkia Shkodër, për gjithëpërfshirjen dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët dhe familjet në nevojë, propozojmë reduktimin ose shërbimin pa pagesë në kopsht dhe çerdhe të disa kategorive sipas kritereve dhe proçedurës së përcaktuar më poshtë:
Përfitojnë shërbim pa pagesë në kopsht/cerdhe familjet në nevojë si më poshtë:

- Fëmijë të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulta ku përfshihen dhe familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, referuar të dhënave të publikuara në mënyrë periodike nga INSTAT;
- Fëmijë të famijeve ku njëri prej prindërve ose te dy prindërit janë me aftësi të kufizuar fizike ose mendore sipas vlerësimit të Komisionit Mjeko Ligjor, dhe të ardhurat janë deri në nivelin e pagës minimale të miratuar (ku nuk përfshihen të ardhurat nga ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë);
- Fëmijët e familjeve ku kryefamiljare është grua e ve, sipas certifikatës të gjendjes familjare, familje një prindërore, familjet ku kryefamiljare është gruaja që është është viktimë të dhunës në familje (me Urdhër Mbrojtje), por që kanë të ardhura deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi;

- Fëmijë të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulta ku përfshihen dhe familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, referuar të dhënave të publikuara në mënyrë periodike nga INSTAT;
- Fëmijë të famijeve ku njëri prej prindërve ose te dy prindërit janë me aftësi të kufizuar fizike ose mendore sipas vlerësimit të Komisionit Mjeko Ligjor, dhe të ardhurat janë deri në nivelin e pagës minimale të miratuar (ku nuk përfshihen të ardhurat nga ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë);
- Fëmijët e familjeve ku kryefamiljare është grua e ve, sipas certifikatës të gjendjes familjare, familje një prindërore, familjet ku kryefamiljare është gruaja që është është viktimë të dhunës në familje (me Urdhër Mbrojtje), por që kanë të ardhura deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi;

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit:** Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifaveështë Drejtoria e Kopshte Çerdheve, e cila merr informacionin nga kopshtet dhe çerdhet per frekuentimin e fëmijëve, institucione që ofrojnë shërbimet dhe nga kryetari i bashkisë për kategoritë e lehtësuara.

Për të përfituar nga reduktimi ose përjashtimi nga detyrimi mujor në kopsht dhe cerdhe, aplikimi bëhet pranë Zyrën me një ndalesë, dhe pas vlerësimit social ekonomik të rastit nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, dhe miratim të kryetarit të Bashkisë, referohet për regjistrim pa tarifë pranë kopshtit/çerdhes përkatëse.

Tabelë 36.Tarifa për shërbimet administrative

| III.4.8.2 | Emertimi | Njësi | Vlerë |
|---|---|---|---|
| 1 | Tarifa nga dokumentat për tender ose ankand | Lekë/dokumenta | 2,000 |
| 2 | Tarifë aplikimi për dhënie dublikatë arkivi | Lekë/aplikim | 500 |
| 3 | Tarifë aplikimi për dhënie dublikatë arkivi mbi 10 faqe, tarifë për çdo faqe të dublikatës së arkivit të njësuar me origjinalin (shtesë mbi tarifën e sipërshënuar) | Lekë/faqe | 10 |
| 4 | Tarifa për shërbimet e ofruara ndaj përmbaruesve gjyqësor privat, ku përfshihen, Publikim i njoftimit të ankandit, publikime të tjera të akteve përmbarimore,Mbajtja e korrespondencës (Vërtetime/Konfirmime në rast të realizimit të publikimit/afishimit) | Lekë/shërbim | 300 |

Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave:**

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës për shërbimet administrative:
Për tarifën nga tendera dhe ankand Njësia e Prokurimit ose Ankandit përcjell informacionin tek Drejtoria e të Ardhurave, e cila nga ana e saj ndjek mbledhjen e të ardhurës përkatëse

Për të përfituar nga reduktimi ose përjashtimi nga detyrimi mujor në kopsht dhe çerdhe aplikohet në Zyrën me një ndalesë, dhe pas vlerësimit social ekonomik të rastit nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, dhe miratim të kryetarit të Bashkisë, referohet për regjistrim pa tarifë pranë kopshtit/çerdhes përkatëse.

Për pikat 2 dhe 3, Sektori i Protokoll Arkivës, pranë Drejtorisë Burimeve Njerëzore, bëjne llogaritjet dhe percjellin informacionin pranë Drejtorisë së të Ardhurave, për lëshimin e faturës.
Për pikën 4 Drejtoria Juridike dheDrejtoriae të Ardhurave zbatojnë procedurën standarte tëveprimit të miratuar.
Drejtoritë/Institucionet përkatëse përcjellin informacionin tek Drejtoria e të Ardhurave në mënyrë periodike dhe nuk ofrojnë shërbimin përkatës pa u kryer shlyerja e detyrimit.

### *III.4.9. Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj.*

Tabelë 37 Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

| | Tarifat e shërbimeve | Njësia | Tarifa |
|---|---|---|---|
| I | Për kundërfirmimin e studimeve urbanistike, të planeve rregulluese, projekteve të shesheve të te ndërtimit dhe të objekteve brenda tyre. | | |
| I.1 | Për projektet e mbrojtjes nga zjarri, që u bëhen studimeve urbanistike dhe planeve rregulluese. | Lekë | 0.5 për qind e vlerës se projektit |
| I.2 | Për banesat, rikonstruksionet e tyre e shtesë kati në to, si dhe për çdo lloj objekti ndërtimi, me vlerë deri ne 1 000 000 Lekë. | Lekë | 500 |
| I.3 | Për banesat, dyqanet, lokalet, serviset, repartet artizanale, magazina mallrash etj., me vlerë investimi nga 1 000 000 deri ne 2 000 000 Lekë. | Lekë | 1,000 |
| I.4 | Për hotelet, motelet, rezidencat, komplekse dyqanesh ose supermarkete me vlerë investimi deri në 20 000 000 Lekë. | Lekë | 5,000 |
| I.5 | Për objektet me vlerë investimi deri në 50 000 000 Lekë. | Lekë | 10,000 |
| I.6 | Për objektet me vlere investimi mbi 50 000 000 Lekë. | Lekë | 15,000 |
| I.7 | Për ndërtime qyteza e fshatra turistike, si dhe për vepra të tjera me vlerë investimi mbi 1 000000 USD. | Lekë | 50,000 |
| 2 | Për objektet me rrezik të theksuar për rënie zjarri e shpërthimi. | | |
| 2.1 | Për fabrikat, uzinat e qendrat e përpunimit te naftës e gazit të lëngëzuar, fabrikat e polisterolit e për prodhime kimikatesh, si dhe për vepra e objekte me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorive "A" dhe "B" (përcaktuar me rregulloren e projektimit të ndërtesave të çdo lloji). | Lekë | 30,000 |
| 2.2 | Për depo qendrore karburanti, pika të shitjes së karburanteve dhe impianti të depozitimit dhe mbushjes të bombolave me gaz të lëngëzuar. | Lekë | 20,000 |
| 2.3 | Për qendra e magazina të depozitimit të gazit të lëngshëm me shumicë, të karburanteve e lubrifikantëve në fuçi, të kimikateve e lëndëve të tjera me rrezik zjarri. | Lekë | 15,000 |
| 2.4 | Për projekte të shfrytëzimit të burimeve të naftës, puse të shpim-kërkimit për tubacionet magjistrale | Lekë | 20,000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | të transportimit dhe për të gjithë infrastrukturën që lidhet me shfrytëzimin e tyre. | | |
| 2.5 | Për fabrika mielli, përpunimi druri, përpunimi të bimëve medicinale, të prodhimit të veshjeve dhe objekteve të tjera me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorisë "C". | Lekë | 15,000 |
| 2.6 | Për fabrika e ndërmarrje të përpunimit e prodhimit të produkteve ushqimore, të detergjenteve, të prodhimit kozmetik, të pijeve alkoolike. | Lekë | 20,000 |
| 2.7 | Për rikonstruksionet qëkryen në të gjitha këto objekte, të cilat bëhen në bazë të projekteve përkatëse | Lekë | 5,000 |
| 3 | Për kontrollin teknik pas përfundimit të punimeve | | |
| 3.1 | Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në përfundimin e veprës apo te objektit, kontrollon, harton dhe u jep personave, juridike e fizike, shoqërive, private e shtetërore, aktin teknik përkatës | Lekë | 5,000 |
| 3.2 | Për përdorimin e automjeteve (autobote) që transportojnë karburante, gaze të lëngëzuar, alkoole, kimikate me rrezik zjarri, jepet akti teknik për plotësimin e normave teknike te mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. | Lekë | 1,000 |
| 3.3 | Për ripërtëritjen vjetore te aktit teknik | Lekë | 1,000 |
| 4 | Dhënia personave juridike, vendas e të huaj, licencën për prodhimin, mirëmbajtjen dhe tregtimin e teknikës, pajisjeve zjarrfikëse dhe lëndëve për shuarjen e zjarrit | Lekë | 25,000 |
| 4.1 | Ripërtëritja e licencës. | Lekë | 10,000 |
| 5 | Për kryerjen e aktekspertizes për zjarret e rena, kur kërkohet nga organet e prokurorisë, te gjykatës ose nga vete shtetasit, personat, juridike e fizike, vendas e te huaj | Lekë | 25,000 |
| 6 | Per ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve nga shërbimi i MZSH-së në objektet e siguruara nga zjarri nga shoqëritë e sigurimit | Lekë/orë/ ndërhyrje | 15.000 |

**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës:** Drejtoria Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi ben llogaritjet, leshon faturen per arketim si dhe ndjek vjeljen e te ardhurave.

### *III.4.10. Tarifat e përkohshme*

| | | Njësia | Tarifa |
|---|---|---|---|
| 1 | Tarifë dorëzim dokumentacioni për AMTP | Lekë/aplikim | 300 Lekë |
| 2 | Tarifë për studim dhe projektim objekte dhe hapësira publike | Përqindja e kostos mesatare të ndërtimit të banesave përcaktuar nga enti kombëtar i banesave | 1 (një) % |

Për pikën 1, Zyrat me një ndalesë në të gjithë territorin leshojnë faturën për arkëtim për të gjithë aplikuesit pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP, e cila pasqyrohet në

sistemin informatik të taksave dhe tarifave vendore. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit te AMTP nuk vazhdon procedurën pa arkëtimin e faturës.

### *III.4.11. Tarifa për zënien e hapësirave publike*

Përkufizimi: Tarifa për zënien e hapësirave publike paguhet për zënien e hapësirave publike. Tarifa llogaritet si detyrim mujor/sezonal i subjektit/individit.

Baza e tarifës: Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në $m^2$, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi, aktivitete, etj.

Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive për zënien e hapësirave publike paraqitet si më poshtë:[25]

Tabelë 38. Niveli i tarifës për zënien e hapësirave publike

| | Destinacioni i hapësirës | Njësia | Tarifa |
|---|---|---|---|
| 1. | Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)NjA Shkodër | Lekë/m²/muaj | 300 |
| 2 | Zenie e hapesires publike (perdorim trualli) në qendrën e Qytetit Shkoder Rr. 13 Dhjetori, 28 Nentori dhe Kolë Idromeno. | Lekë/m²/muaj | 350 |
| 3 | Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)NjA të tjera (përveç Shkodër, Plazh Velipojë - Rrjoll) | | 70 |
| 4 | Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona A/V (nga qëndra me koordinata 41°51'41.36"N, 19°25'29.33"E në drejtim të Vilunit me koordinata 41°51'36.34"N, 19°25'59.29"E) | Lekë/m2/muaj | 140 |
| 5 | Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona A/B (nga qëndra me koordinata 41°51'41.36"N, 19°25'29.33"E në drejtim të Derdhjes së Bunës me koordinata 41°51'32.70"N, 19°24'42.73"E) | Lekë/m2/muaj | 140 |
| 6 | Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona B/V (nga koordinatat 41°51'36.34"N, 19°25'59.29"E në drejtim të | Lekë/m2/muaj | 100 |

[25] Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:
-*"Rritje deri në kufirin maksimal të tarifës për zënien e hapësirës publike në qytet dhe përforcimin e kontrolleve të zënies së paligjshme duke detyruar me gjoba dhe sekuestrim të mjeteve të përdorura."*
Aktualisht Bashkia Shkodër faturon subjektet për përdorimin e hapësirës publike (përdorim trualli) me vlerën 140 Lekë/m2/muaj, për vendosje travolina, vazo, rrethime dekorative, etj.
Duke parë kërkesat ne rritje të subjekteve për shfrytëzimin e hapësirave publike, si dhe nga ana tjetër të nevojës për vënie në dispozicion të sa më shumë hapsirave publike për qytetarët, propozohet rritja e tarifës në qytet në masën 300 lekë/m2/muaj dhe rritjes në masën 350 lekë/m2 /muaj në qendrën e qytetit: përkatësisht në rrugët "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno", ku të ardhurat e rritura do të shërbejnë për zgjerimin e hapsirave të reja për qytetarët dhe përmirësimin e cilësisë urbane të tyre.

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Vilunit me koordinata 41°51'29.70"N, 19°26'46.75"E) | | |
| 7 | Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Velipojë - Zona B/B (nga koordinatat 41°51'32.70"N, 19°24'42.73"E në drejtim të të Derdhjes së Bunës me koordinata 41°51'12.06"N, 19°24'00.00"E) | Lekë/m2/muaj | 100 |
| 8 | Zënie e hapësirës publike në plazh ranor Rrjoll - Zona A/Rr (nga koordinatat 41°51'20.61"N, 19°27'44.45"E në drejtim të Rërës së Hedhur me koordinata 41°51'10.98"N, 19°28'32.81"E) | Lekë/m2/muaj | 100 |
| 9 | Zënia e hapësirës publike ditore për qëllime biznesi: ekspozim – promocioni produkteve,i shërbimeve, aktivitete tregtare, etj. | Lekë/m²/ditë | 200 |

**Përjashtime**: Përjashtohen nga tarifa e zënies së hapësirës publike ditore, subjektet që zhvillojnë aktivitete në partneritet me Bashkinë Shkodër.

**Detyrimi për pagesën:** Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Projektimit të Investimeve harton planin për zënien e hapësirës publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, ku përcakton zonën, sipërfaqen, periudhën dhe qëllimin e lejuar të shfrytëzimit. Drejtoria e të Ardhurave ose Zyra me Një Ndalesë sipas konfigurimit në sistem, bazuar në planin e hartuar, nënshkruan kontratat me subjektet që kanë paraqitur kërkesën. Drejtoria e të Ardhurave faturon, monitoron dhe ndjek shlyerjen e detyrimit.
Derdhja e të ardhurave për këtë tarifë në favor të bashkisë, bëhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës mes palëve.
**Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës**: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Shkodër.

### *III.4.12 Tarifa e përcaktuar për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille.*

Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose landfillet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Tarifa e përcaktuar për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille duhet të mbulojë koston e operimit për trajtimin e këtyre mbetjeve, si dhe koston për mbylljen e kujdesin pas mbylljes së landfillit për një periudhë prej të paktën 30 (tridhjetë) vjetësh.

Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve publike dhe infrastrukturës,Drejtoria e studimeve, planifikimit, koordinimit tëinvestimeve dhe Drejtoria e mjedisit, pyjeve dhe menaxhimit të ujërave planifikojnëvenddepozitimin e përkohshëm ose landfillet e trajtimit të mbetjeve inerte.

Tabelë 39. Niveli i tarifës për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille

| | Emërtime | Njësia | Tarifa |
|---|---|---|---|
| 1 | Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille | Lekë/ton/mbetje | 300 |

## Kapitulli IV. Gjoba, Kamatvonesa

### IV. 1. Kamatvonesë për mosshlyerje në afat të detyrimit

Tabelë 40. Mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa)

| IV.1 | Emërtimi | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| a) | Kamatvonesa për mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa) brenda afatit 30 qershor | %/rast | Për çdo muaj vonesë 5 % e vlerës së detyrimit total të papaguar (maksimumi 25%) |
| b) | Nëse subjekti i ri ose adresa sekondare e re regjistrohen pas datës 30 qershor, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve është 30 ditë pas datës së regjistrimit. | %/rast | Për çdo muaj vonesë 5 % e vlerës së detyrimit total të papaguar (maksimumi 25%) |

Kamatvonesat aplikohen vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT).

Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 30 qershor të po këtij viti.

Baza e llogaritjes së kamatvonesëspër zërin IV.1 përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, taksa e ndërtesës dhe taksa e truallit.

Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat dt. 30 qershorpër shlyerjen e detyrimit. Nëse çelja bëhet pas datës 30 qershor, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve tatimore është 30 ditë pas datës së rregjistrimit.

Vlera e kamatvonesës llogaritet 5% (pesë përqind) për muajin e plotë kalendarik brënda së cilës skadon afati, dhe 5% (pesë përqind) për cdo muaj të plotë kalendarik në vazhdim, por në asnjë rast shuma totale e kamatvonesësnuk mund të jetë më e madhe se 25% (njëzet e pesë përqind) e detyrimit vjetor të papaguar.

**Struktura e ngarkuar** për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre kamatvonesave është Drejtoria e të Ardhurave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

## IV.2. Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore

Tabelë 41. Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore

| Nr. | Emërtimi | Gjoba |
|---|---|---|
| 1 | Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore | *Sipas* Ligjit Nr.9920, dt. 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperise", i ndryshuar |

## IV.3. Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundërvajtjet administrative

Tabelë 42. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore

| IV.3.1 | Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të jetë si më poshtë | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Dëmtim rruge | Lekë | 20,000 |
| 3 | Bllokim rruge | Lekë | 10,000 |
| 4 | Dëmtim bordure | Lekë | 10,000 |
| 5 | Dëmtim trotuari | Lekë | 20,000 |
| 7 | Bllokim trotuari | Lekë | 10,000 |
| 8 | Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete | Lekë | 20,000 |
| 9 | Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet : | | |
| | • persona juridikë | Lekë | 15,000 |
| | • persona fizikë | Lekë | 10,000 |
| | • qytetarë | Lekë | 10,000 |
| 10 | Bllokim rampë trotuari[26] | Lekë | 2,000 |
| 11 | Bllokim vendparkimi të dedikuar për PAK | Lekë | 2,000 |

Tabelë 43. Niveli i gjobave për ndotje të hapësirës publike

| IV.3.2 | Niveli i gjobave për ndotje e ambientit/hapësirës publike[27] | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|

[26] Këshilli bashkiak, Komisioni i Shërbimeve sociale dhe strehimit, ka paraqitur sugjerimet për ndryshimet në tabelën e gjobave për ndërhyrjen në infrastukturën rrugore, duke propozuar shtimin e 2 gjobave:
- Bllokim rampë trotuari, gjobë 2,000Lekë
- Bllokim vendparkimi të dedikuar për PAK, gjobë 2,000Lekë

Të ardhurat e mbledhura për këto dy zëra, të dedikohen për investime në infrastrukturë apo mbështetje të aktiviteteve të personave me aftësi ndryshe.

[27]Me shkresën nr 19979, datë 19.11.2019, "Mbi sugjerimet nga Këshilli Bashkiak Shkodër për paketën fiskale 2020" është propozuar që:
-*"Rritja në nivel maksimal të gjobave për bizneset tregtare që hedhin mbeturinat në rruge dhe kanale, pa diferencim nëse janë individë, persona juridike, apo ndarje si biznes i madh dhe i vogël."*
Në këtë rast është konsideruar niveli maksimal i lejuar me ligj.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Hedhje e mbetjeve urbane në rrugë, trotuar, kudo në hapësirën publike, jashtë vendeve të përcaktuara: | | |
| | • persona juridikë | Lekë/rast | 20,000 |
| | • persona fizikë | Lekë/rast | 15,000 |
| | • qytetarë | Lekë/rast | 10,000 |
| 2 | Hedhje inerte në vende të pamiratuara | | |
| | • persona juridikë | Lekë/rast | 20,000 |
| | • persona fizikë | Lekë/rast | 15,000 |
| | • qytetarë | Lekë/rast | 10,000 |
| 3 | Vendosje pa leje e posterave, tabelave, banderolave, ndërhyrje ne fasadën e ndërtesave, (vendosje e kabllove, shfrytëzimi i tyre si suport, dëmtimi apo ngjyrosja e tyre, etj) | Lekë /rast | 20,000 |
| 4 | Lëvizje me kafshë në rrugë automobilistike dhe hapësira publike e plazhe. | Lekë/rast | 20,000 |
| 5 | Ndotje akustike, krijimi i zhurmave artificiale (nga njerëz, altopolantë, megafonë, zhurma brenda apartamentave, banesave etj) | Lekë/rast | 15,000 |
| 6 | Dëmtimi i posterave, tabelave, banderolave, afishimeve, shpalljeve publike etj. të vendosura nga bashkia ose me leje nga bashkia | Lekë/rast | 20,000 |
| 7 | Ndotje akustike (sa më lart, rast i përsëritur) | Lekë/rast | 20,000 |

Tabelë 44. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse

| IV.3.3 | Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregtar pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse, mosrespektim tabelave rrugore. | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Mospajisja me liçensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti: | | |
| | • Motokarro | Lekë/rast | 2,000 |
| | • Transport udhëtarësh taksi (1+4) | Lekë/rast | 10,000 |
| | • Transport udhëtarësh taksi (1+8) | Lekë/rast | 15,000 |
| | • Mjete të tonazhit të lartë | Lekë/rast | 20,000 |
| | • Hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë | Lekë/rast | 15,000 |

Me propozimin të komisionit të shëndetësisë, veterinarisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, të Këshillit Bashkiak Shkodër "Propozim për ndryshim në projekt akt" me nr 22069, datë 19.12.2019, në tabelën e gjobave për ndërhyrjen në infrastukturën rrugore, niveli i gjobës për :

- Ndotje akustike, krijimi i zhurmave artificiale (nga njerëz, altopolantë, megafonë, zhurma brenda apartamentave, banesave etj) nga 3000 Lekë/rast bëhët 15,000 Lekë/rast.
- Ndotje akustike (sa më lart, rast i përsëritur) nga 10000 Lekë/rast, bëhët 20,000 Lekë/rast.

| | | | |
|---|---|---|---|
| | • Mosrespektim i orarit të përcaktuar për mjetet e liçensuara për transport publik | Lekë/rast | 5,000 |
| | • Lëvizje e automjeteve në linja ndërqytetase dhe rrethqytetase që nuk respektojnë dispozitat ligjore. | Lekë/rast | 10,000 |
| 2 | Shitje e lëndëve djegëse pa liçensë, për përdorim nga konsumatorët fundorë | Lekë/rast | 15,000 |
| 3 | Mospajisje me leje për zenie të hapësirës publike | | |
| | • Zënie hapësire për ekspozim malli | Lekë/rast | 5,000 |
| | • Veprimtari të ndryshme fitimprurëse ose promocionale që zhvillohen në hapësirat publike | Lekë/rast | 10,000 |
| | • Zënie hapësire publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit (rasti i parë) | Lekë/rast | 10,000 |
| | • Zënie hapësire publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit (rasti i përsëritur) | Lekë/rast | 20,000 |
| | • Zënie hapësire publike nga tregtarë ambulante (rasti i parë) | Lekë/rast | 1.000 |
| | • Zënie hapësire publike nga tregtarë ambulante (rasti i përsëritur) | Lekë/rast | 3.000 |
| | • Rezervim i parkingut pa leje nga bashkia (rasti i parë) | Lekë/vendparkim | 10.000 |
| | • Rezervim i parkingut pa leje nga bashkia (rasti i përsëritur) | Lekë/vendparkim | 20.000 |
| 4 | Mospajisje me leje për vendosje reklame : | | |
| | • e thjeshtë | Lekë/reklamë | 10,000 |
| | • elektronike. | Lekë/reklamë | 20,000 |
| 5 | Shfrytëzimi i hapësirave publike për vendosjen e antenave të kompanive culare, interentit, TV, etj pa leje | Lekë/rast | 20,000 |
| 6 | Mosmarrja e masave për izolimin e ambjentit për daljen e zhurmave nga ambjentet e lokaleve. | Lekë/rast | 20,000 |
| 7 | Vendosje pa leje e antenave valore për kompanitë celulare dhe radiotelevizive | Lekë/antenë | 20.000 |
| 8 | Përdorim ndriçuesi, reklamave me drita, etj. në vende publike që shkaktojnë verbim për drejtuesit e automjeteve dhe këmbësorët | Lekë/rast | 5.000 |
| 9 | Mosrespektim i tabelave të qarkullimit rrugor, dhe tabelave të tjera kufizuese të vendosura nga organet kompetente | Lekë/rast | 5.000 |

Tabelë 45.Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor

| IV.3.4. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor | Njësia | Vlera |
|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Lidhje në rrjetin ajror të ndriçimit publik | Lekë | 20,000 |
| 2 | Dëmtim të shtyllave të ndriçimit publik | Lekë | 20,000 |
| 3 | Dëmtim i ndriçuesve të ndriçimit publik | Lekë | 20,000 |
| 4 | Përdorimi i shtyllave (i të gjitha llojeve) si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllove etj. | Lekë | 10,000 |
| 5 | Dëmtim i traseve, kabllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave. | Lekë | 20,000 |
| 6 | Ndërhyrje në kuadrot elektrik publik | Lekë | 10,000 |

Tabelë 46. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit

| IV.3.5 | Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit : | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Lidhje e pa miratuar në tubacion | Lekë/rast | 20,000 |
| 2 | Dëmtim i pusetave | Lekë/rast | 20,000 |
| 3 | Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje | Lekë/rast | 20,000 |
| 4 | Shpërdorimi i ujit të pijshëm nga konsumatori familjar | Lekë/rast | 5,000 |
| 5 | Shpërdorimi i ujit të pijshëm nga konsumatori biznes | Lekë/rast | 10,000 |

Tabelë 47. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbërta

| IV.3.6 | Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbërta dhe publike | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta | Lekë/rast | 20,000 Lekë |
| 2 | Dëmtim, prerje e pemëve | Lekë/rast | 20,000 Lekë |
| 3 | Zënie e hapësires së gjelbër pa leje | Lekë/rast | 20,000 Lekë |

Tabelë 48. Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar

| IV.3.7. | Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar të jetë si më poshtë : | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Për mishin e therur të tregtuar të pa çertifikuar nga Inspektoriati Veterinar | Lekë/rast | 10,000 Lekë |
| 2 | Në rast të mosmarrjes së masave për izolimin kafshëve te luksit | Lekë/rast | 5,000 Lekë |

Tabelë 49. Niveli i gjobës për përdorimin e pa autorizuar të logos së Bashkisë së Shkodrës dhe moszbatim i akteve, vendimeve administrative të dala nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë

| IV.3.8. | Niveli i gjobave për kundravajtje të tjera : | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Përdorimin e pa autorizuar të logos së Bashkisë | Lekë | 20,000 |
| 2 | Mosrespektim i akteve, vendimeve administrative të dala nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë | Lekë | 20,000 |
| 3 | Dëmtim aseti publik | Lekë | 10,000 |

Zbatimi i këtyre penaliteteve i ngarkohet Policisë Bashkiake, e cila regjistron gjobat në sistemin informatik të takasve dhe tarifave vendore të Bashkisë Shkodër dhe ndjek nga ana ligjore arkëtimin e tyre.

Drejtoria e të ardhurave llogarit kamatvonesat e gjobave.

Për çdo rast dëmtimi të aseteve publike, krahas masës administrative, subjektet janë të detyruara që të kthejnë ambientin në gjendjen e mëparshme, ose të zhdëmtojnë vlerën e dëmit të shkaktuar sipas vlerësimit nga institucioni përgjegjës.

**Përjashtohen** nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara në Ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

## Kapitulli V Të ardhura jo tatimore

### V.1. Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Sipas përcaktimeve ligjore pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nënndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhurat nga qiratë paguhen nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.

Drejtoria Juridike, Njësia e Prokurimitdhe sektori i Aseteve kryejnë procedurën e plotë të dhënies me qira deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnëlëshimin e faturës nga ana e Drejtorisësë të Ardhurave. Ndjekja e zbatimit të kontratës kryhet nga Sektori i Aseteve.

### V.2. Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime

Bazuar në Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" si dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011,"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", të ndryshuar, të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Nëpunësit Autorizues të të gjithë niveleve të njësise publike kanë detyrimin që të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim të shkaktarëve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve.

### V.3. Të ardhura nga shitja e mallrave dhee shërbimeve

Sipas përcaktimeve ligjore janë të ardhura që përfshihen në zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve nëpërdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

### V.4.Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

Sipas përcaktimeve në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore", akteve normative dhe procedurave ligjore, Bashkitë krijojnë të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

### V.5. Të ardhura nga privatizimi

Baza ligjore për të ardhurat nga privatizimi: VKM nr.97, datë 3.2.2008 "Për proçedurat e privatizimit të banesave objekt i ligjit 7652, datë 23. 12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe ligjit 9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa me fondet të shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore dhe VKB nr. 153 dt.11.12.2012 "Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave

Të ardhurat nga privatizimi paguhen nga përfituesi i pronës. Drejtoria Juridike ose komisioni përgjegjës përcjell dokumentacionin e përpunuar për lëshimin e faturës te Drejtoria e të Ardhurave, që lëshon faturën për arkëtim.

## V.6. Të ardhura nga komisioni si agjent tatimor.

Baza ligjore për të ardhurat nga komisioni si agjent tatimor për mbledhjen e Takses se akteve dhe e pullës: neni 5 i ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 *"Për Taksat Kombëtare",* i ndryshuar.

Sipas nenit 8, germa "ç", të këtij ligji, taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5, shtojca nr. 3, të këtij ligji, dhe transferohen në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore dhe të llogarive të njësive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj. Agjentët e taksave, për shërbimin që kryejnë, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të taksave që kanë transferuar në llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore. Masa e komisionit për taksën e akteve dhe të pullës është 5 për qind;

## V.7. Të tjera.

Tarifat vjetore për subjektet llogariten dhe faturohen për çdo njësi referuar çdo vendi të ushtrimit të aktivitetit sipas Regjistrit Tregtar të Qëndrës Kombëtare të Biznesit, si dhe llojit e vendodhjes së aktivitetit për çdo rast.

Per njesite "Kompleks shërbimesh"(Njësi me nje adresë në QKB, por me më shumë se një aktivitet në këtë adresë, sipas verifikimit në terren, psh: tregtim karburant, bar, hotel, restorant, etj), do te faturohen veçmas per secilin aktivitet per tarifat vendore vjetore.

Për tarifimin e subjekteve të ndërtimit, merret për bazë adresa kryesore sipas QKB-së (selia administrative). Përveç këtyre rasteve, kur adresa kryesore është në juridiksion të Bashkisë Shkodër, përjashtohen nga tarifat vjetore (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj) të gjithë vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, sipas QKB-së (adresa sekondare, kantiere ndërtimi), dhe detyrimi i tarifës së pastrimit për punimet që kryhen, është shlyer në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit ose deklaratës paraprake të punimeve nga investitori. Nuk përjashtohen nga detyrimet tarifore vjetore zyrat e shitjes, ekspozimit, kontabilitetit, financës etj, që ushtrojnë aktivitet dhe ndodhen në ambientet e kantiereve të ndërtimit, por trajtohen referuar paketës fiskale.

Për automjetet që janë në funksion të subjekteve që nuk kanë aktivitet transport malli/udhëtari për vete ose për të tretë, nuk llogariten tarifa vjetore për çdo targë automjeti, të pasqyruar si adresë sekondare, në ekstraktin historik të QKB-së.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA SHKODER

Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për bizneset që regjistohen ose çregjistrohen përgjatë vitit, do të llogariten në proporcion si muaj të plotë për çdo muaj që ka ushtruar aktivitet, edhe nëse aktiviteti nuk është kryer për gjithë muajin.

Profesionet e lira do te quhen subjektet, bazuar në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë.Nëse subjekti eshte biznes i madh, ai do të trajtohet me taksat dhe tarifat, si njësitë e tregtisë dhe shërbimit.

Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimit të zyrës së taksave, bëhet te struktura vendore e apelimit tatimor, pas ankimit administrativ, sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, me VKB Nr.: 56 Datë.: 19.07.2018 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të apelimit tatimor në Bashkinë Shkodër".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR